

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar**

**P1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 21.09.2024

## Problemi 1

Më poshtë është pasqyra e pozicionit financiar të Kompanisë Pula dhe Kompanisë Sani më 31 Dhjetor 2023.

### Pasqyrat e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023.

	Kompania Pula	Kompania Sani
PASURITE	EUR	EUR
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Toka dhe ndërtesa	2,200,000	1,000,000
Pajisjet	500,000	100,000
Investimet në kompaninë Sani	2,200,000	0
Pasuritë tjera jo-qarkulluese	308,000	300,000
<i>Total Pasuritë jo-qarkulluese</i>	<b>5,208,000</b>	<b>1,400,000</b>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	222,000	1,000,000
Llogaritë e arkëtueshme	260,000	1,600,000
Paraja në bankë	840,000	100,000
<i>Total Pasuritë qarkulluese</i>	<b>1,322,000</b>	<b>2,700,000</b>
<b>Total Pasuritë</b>	<b>6,530,000</b>	<b>4,100,000</b>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar (1eur për aksion)	3,000,000	1,250,000
Fitimi i mbajtur	1,500,000	2,300,000
<i>Total Ekuiteti</i>	<b>4,500,000</b>	<b>3,550,000</b>
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kredia afatgjatë	800,000	200,000
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Kredia afatshkurtër	470,000	250,000
Llogaritë e pagueshme	760,000	100,000
<i>Total Detyrimet</i>	<b>1,230,000</b>	<b>350,000</b>
<b>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	<b>6,530,000</b>	<b>4,100,000</b>

Informata shtesë:

1. Para 3 viteve Kompania Pula ka investuar në kompaninë Sani në shumë prej 2,200,000 EUR dhe ka blerë 1,000,000 aksione të rregullta. Fitimet e mbajtura në blerje ishin 800,000 EUR.
2. Në datën e blerjes vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues ishte 412,500 EUR.
3. Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2023, Kompania Pula i ka shitur kompanisë Sani disa mallra për 1,000,000 EUR, prej të cilave 20% kishin mbetur të pasitura në stoqe. Kompania Pula përdor metodën e shtimit të kostos me një marzhë prej 25% mbi kosto për çdo gjë që shet.

**Kërkohet:**

**Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023**

**(20 Pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

### Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023

PASURITE	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Toka dhe ndërtesa (2,200 + 1,000)	3,200,000
Pajisjet (500 + 100)	600,000
Pasuritë tjera jo-qarkulluese (308+300)	608,000
Zëri I mirë	562,500
<i>Total Pasuritë jo-qarkulluese</i>	4,970,500
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (222+1000 - 40 (LL6))	1,182,000
Llogaritë e arkëtueshme (50 + 1,600)	1,860,000
Paraja në bankë (50 + 100)	940,000
<i>Total Pasuritë qarkulluese</i>	3,982,000
<b>TOTAL PASURITE</b>	<b>8,952,500</b>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>	
Kapitali aksionar	3,000,000
Fitimi i mbajtur (LL5)	<b>2,668,000</b>
Interesi jo-kontrollues (LL3)	<b>704,500</b>
<i>Total Ekuiteti</i>	6,372,500
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Kredia afatgjatë (800 + 100)	1,000,000
<i>Detyrimet afatshkurta</i>	
Kredia afatshkurtër	720,000
Llogaritë e pagueshme (680 + 350)	860,000
<i>Total Detyrimet afatshkurta</i>	1,580,000
<i>Total Detyrimet</i>	2,580,000
<b>TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<b>8,952,500</b>

### Llogaritjet:

<b>1. Struktura e grupit</b>	
Aksionet e blera në Sani	1,000,000
Kapitali aksionar i Sani	1,250,000
Përqindja e aksioneve të blera (1,000,000/1,250,000)	80%
Interesi jo kontrollues	20%

<b>2. Zëri i mirë</b>	
Konsiderata e transferuar	2,200,000
Vlerë e drejtë e IJK në blerje	412,500
<b>Pasuritë neto</b>	
Kapitali aksionar	1,250,000
Fitimet e mbajtura në blerje	800,000
	(2,050,000)
<b>Zëri I mirë</b>	<b>562,500</b>

<b>3. Fitimet e mbajtura</b>		
	<i>Pula</i>	<i>Sani</i>
Sipas bilancit:	1,500,000	2,300,000
Fitimet e mbajtura në blerje	-	(800,000)
Fitimi i porealizuar (LL5)	-	(40,000)

	-	<b><u>1,460,000</u></b>
Pula: Pjesa e fitimit që i takon grupit 80% x 1,460,000		
	1,168,000	
	<b><u>2,668,000</u></b>	

<b>4. Interesi jo-kontrollues</b>	
IJK në blerje	412,500
Pjesa e fitimit që I takon IJK-së (LL3) 1,460,000 X 20%	292,000
<b>IJK në datën e raportimit</b>	<b><u>704,500</u></b>

<b>5. Fitimi I perealizuar</b>	
Shitjet 125%	1,000,000
KMSH 100%	(800,000)
Fitimi bruto 25%	200,000
Fitimi i perealizuar 200,000 x 20%	<b>40,000</b>

## Problemi 2

PLM Sh.p.k. është duke bërë korrigjimet përfundimtare të draftit të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2023.

<b>Bilanci Vërtetues</b>	<b>Eur</b>	<b>Eur</b>
Toka me kosto	31,896,000	
Ndërtesa me kosto	150,000,000	
Zhvlerësimi I akumuluar i ndërtesave me 1 janar 2023		48,792,000
Pajisjet e zyrës me kosto	33,185,185	
Stoqet	11,000,000	
Llogaritë e arkëtueshme	16,800,000	
Kapitali aksionar (0.75 eur për aksion)		46,000,000
Premia në aksione		22,000,000
Fitimet e mbajtura në fillim të vitit		50,735,185
Kredia afatgjatë		50,000,000
Kredia afatshkurtër		15,000,000
Tatimi I pagueshëm		8,854,000
Të hyrat nga shitja		20,000,000
Kosto e mallrave të shitur	15,000,000	
Shpenzimet operative	1,600,000	
Shpenzimet e interesit	1,900,000	
<b>TOTAL</b>	<b>261,381,185</b>	<b>261,381,185</b>

### Informata shtesë:

1. Ndërtesa ishte blerë vite më parë dhe vlera e mbetur e saj ishte 70,000,000 eur. Kompania e zhvlerëson ndërtesën me metodën drejtvizore me 35%.
2. Pajisjet e zyrës ishin blerë më 1 janar 2021 dhe që nga ajo datë nuk është regjistruar zhvlerësimi i tyre. Shuma prej 33,185,185 eur paraqet regjistrimin me kosto në PPF. Drejtori financiar ka propozuar që të rikalkulohet zhvlerësimi për 2 vitet e kaluara dhe për vitin 2023 dhe të përfshihet në PF. Kompania përdor metodën e saldove zbritëse prej 25% për pajisjet e zyrës.
3. Gjatë vitit, kompania emetoi 12,000,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 0.75 eur secila, me çmim prej 1 eur për aksion, në këmbim të parave të gatshme. Kontabilisti nuk e ka regjistruar këtë emetim deri më 31/12/2023.
4. PLM Sh.p.k. ka marr kredi afatgjate 50,000,000 eur me normë interesi prej 6% dhe megjithëse detyrimi është regjistruar në libra, duhet të llogaritet interesi përkatës.
5. Ka falimentuar një klient që i detyrohej PLM Sh.p.k. shumën prej 550,000 Eur.
6. Humbja neto për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2023 ishte 49,235,185 Eur.

### **Kërkohet:**

**Duke adresuar shënimet shtesë, përgatitni pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023. (20 Pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

### **Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023**

	Eur	Eur
<b>PASURITE</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Toka	31,896,000	
Ndërtesa (LL1)	73,208,000	
Pajisjet e zyrës (LL2)	14,000,000	
<i>Total Pasuritë jo-qarkulluese</i>		<b>119,104,000</b>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	11,000,000	
Llogaritë e arkëtueshme (LL4)	16,250,000	
Paraja në bankë (LL3)	12,000,000	
<i>Total Pasuritë qarkulluese</i>		39,250,000
<b>TOTAL PASURITE</b>		<b>158,354,000</b>
<i>Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		
Kapitali aksionar (0.75 eur për aksion) (LL3)	55,000,000	
Premia në aksione (LL3)	25,000,000	
Fitimet e mbajtura (LL6)	1,500,000	
<i>Total Ekuiteti</i>		<b>81,500,000</b>
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kredia afatgjatë	50,000,000	
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Kredia afatshkurtër	15,000,000	
Akrualet (LL5)	3,000,000	
Tatimi I pagueshëm	8,854,000	
<i>Total Detyrimet</i>		<b>26,854,000</b>
<i>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</i>		<b>158,354,000</b>

## Llogaritjet

<b>1. Pasuritë</b>	
Ndërtesat me kosto	150,000,000
-----Zhvlerësimi I akumuluar saldo në fillim	48,792,000
----Zhvlerësimi I vitit $(150,000,000 - 70,0000) * 35\%$	28,000,000
----- Zhvlerësimi I akumuluar saldo në fund	(76,792,000)
Vlera neto në libra	73,208,000

<b>2. Pajisjet e zyrës</b>	
Pajisjet e zyrës me kosto	33,185,185
Zhvlerësimi viti 1 $(33,185,185 * 25\%)$	8,296,296
Zhvlerësimi viti 2 $(33,185,185 - 8,296,29) * 25\%$	6,222,222
Zhvlerësimi viti 3-viti aktual $(24,888,889 - 6,222,222) * 25\%$	4,666,667
Vlera neto në libra	14,000,000

<b>3. Emetimi I aksioneve</b>	
Paraja	12,000,000
Vlera nominale e aksioneve të emetuara $(12,000,000 \text{aks} * 0.75)$	9,000,000
Gjithsej kapitali aksionar $(46,000,000 + 9,000,000)$	55,000,000
Premia në aksione $(12,000,000 \text{aks} * 0.25)$	3,000,000
Total Premia në aksione $(22,000,000 + 3,000,000)$	25,000,000

<b>4. LL/A</b>	
LI/A	16,800,000
Borxhi I keq	(550,000)
LL/A neto	16,250,000

<b>5. Interesi I pagueshëm</b>	
Kredia	50,000,000
Interesi aktual $(50,000,000 * 6\%)$	3,000,000

<b>6. Fitimet e mbajtura</b>	
Humbja neto	(49,235,185)
Fitimet e mbajtura saldo në fillim	<u>50,735,185</u>
<b>Fitimet e mbajtura saldo në fund</b>	<b><u>1,500,000</u></b>



### **Problemi 3**

(A) Edona Sh.P.K. është e përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës në Kosovë. Analisti financiar ka kërkuar nga ju, kontabilist i ri i çertifikuar, për ndihmë në kontabilizimin e saktë të Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve (PFP) në kuadër të kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023.

Shpenzimet e mëposhtme kanë ndodhur në hapësirën e mullinjve të erës:

	€
Rregullimi (përgatitja) e hapësirës	80,000
Mirëmbajtja vjetore sapo të bëhet operationale	30,000
Trajnimi i stafit në përdorimin e saktë të mullinjve të erës sapo kur të hyjnë në funksion	25,000
Detyrimet e importit të mallrave të blera	28,000
Ekzaminimi fillestar i hapësirës	40,000
Paga e menaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar mullinjtë e erës	140,000
Pagat e punëtorëve të përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës	300,000
Pagat vjetore të punëtorëve në kohën kur mullinjtë e erës do të hyjnë në funksion	100,000
Kostot e testimit	60,000
Materialet e blera për mullinjtë e erës neto (pa TVSh)	250,000

#### **Kërkohe:**

- a) Kalkuloni shumën që duhet të kapitalizohet si Prona, Fabrika dhe Pajisjet (PFP) për mullinjtë e erës si më lartë. **(15 pikë)**

(B) Zyra qendrore e Edona Sh.P.K. është e vetmja ndërtesë e kompanisë. Vlerësuesi profesional ka rivlerësuar këtë ndërtesë më 01 janar 2023 në 2,100,000€. Edona Sh.P.K. ka miratuar një politikë të rivlerësimit të ndërtesave nga kjo datë e rivlerësimit dhe ka vendosur që jeta origjinale e dobishme e ndërtesave nuk ka ndryshuar si rezultat i rivlerësimit. Ndërtesa është blerë më 01 janar 2013. Kosto e ndërtesës në blerje ka qenë 2,500,000€ dhe zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2022 kapi vlerën 500,000€. Zhvlerësimi është llogaritur në mënyrë lineare (me metodën drejtvizore) për jetën e përdorimit prej 50 viteve. Vlerësuesi profesional beson se vlera e mbetur e ndërtesës do të jetë 600,000€ në fund të jetës së dobishme të saj.

#### **Kërkohe:**

Në përputhje me SNK 16 – Prona, Fabrika dhe Pajisjet:

- (i) Kalkuloni shpenzimet e zhvlerësimit të ndërtesës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 bazuar në informatat e dhëna në skenarin e mësipërm (B) dhe regjistro rivlerësimin e pasurisë në kontabilitet. **(5 pikë)**

**[20 pikë]**

### Zgjidhja e problemit 3

#### (A) Kalkulimi i shumës që duhet të kapitalizohet:

	<b>Vlerat e dhëna në €</b>		<b>Vlerat që plotësojnë kushtet për kapitalizim në €</b>
Rregullimi (përgatitja) e hapësirës	80,000	<b>PO</b>	80,000
Mirëmbajtja vjetore sapo të bëhet operacionale	30,000	<b>JO</b>	
Trajnimi i stafit në përdorimin e saktë të mullinjve të erës sapo të hyjnë në funksion	25,000	<b>JO</b>	
Detyrimet e importit të mallrave të blera	28,000	<b>PO</b>	28,000
Ekzaminimi fillestar i hapësirës	40,000	<b>PO</b>	40,000
Paga e menaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar mullinjtë e erës	140,000	<b>PO</b>	140,000
Pagat e punëtorëve të përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës	300,000	<b>PO</b>	300,000
Pagat vjetore të punëtorëve në kohën kur mullinjtë e erës do të hyjnë në funksion	100,000	<b>JO</b>	
Kostot e testimit	60,000	<b>PO</b>	60,000
Materialet e blera për mullinjtë e erës neto (pa TVSh)	250,000	<b>PO</b>	250,000
			<b>898,000</b>

\* Vlera totale që do të kapitalizohet si pasuri jo-qarkulluese është 898,000€

**(B) Kalkulimi i shumës që duhet të kapitalizohet:**

<b>Ndërtesa ('000€)</b>					
		€			€
01.01.2013	Kosto e blerjes	2,500	01.01.2023	Rezerva e rivlerësimit	400
01.01.2023		2,100			

<b>Zhvlerësimi i akumuluar ('000€)</b>					
		€			€
01.01.2023	Rezerva e rivlerësimit	500	01.01.23	Saldo në fillim	500
			31.12.23	Shp. zhvlerësimit	37.5
			31.12.23		37.5

<b>Rezerva e rivlerësimit ('000€)</b>					
		€			€
			01.01.23	Rivlerësimi i Nd.	100
					100

Debi Zhvlerësimi i akumuluar 500

K: Ndertesa me kosto 400

K:Rezerva e rivlerësimit 100

**Kalkulimi i zhvlerësimit:**

$2,100,000 - 600,000 / 40 \text{ vite} = 37,500$  Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2023

#### **Problemi 4**

Në fund të vitit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare më 30 Qershor 2024 , kontabilisti i firmës CBA sh.p.k vërejtë se në Bilancin Vërtetues nuk barazohej ana debi me anën kredi. Diferenca në mes këtyre shumave ishte bartur në Llogarinë Pezull. Draft Pasqyra e të Ardhurave dhe Pasqyra e Pozitës Financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar edhe Llogarinë Pezull. Gjatë hulumtimit janë gjetur gabimet e mëposhtme :

(i) Shpenzimet e telefonit në vlerë prej 1,320€ ishin harruar(fshirë) nga bilanci vërtetues.

(ii) Më 1 janar 2024 ishin paguar 9,600 € për një blerjen e një impianti, kjo shumë ishte regjistruar si shpenzime të riparimit të impianteve. Kompania zhvlerëson impiantet me normën 20 % në vit me metodën drejtvizore duke ngarkuar në mënyrë proporcionale për periudhën e shfrytëzuar.

(iii) Zbritjet në para të gatshme për muajin Qershor 2024 nuk janë postuar në librat kontabël. Vlerat e tyre ishin :

Zbritjet e lejuara :620 €

Zbritjet e marra : 730€

(iv) Vlera 670€ e cila kishte qenë e parapaguar për sigurim nuk ishin regjistruar fare si shpenzime në momentin e fshirjes së parapagimit.

(v) Në Qershor 2024 totali i kthimeve të shitjeve në vlerë prej 6,750€, ishin kredituar llogarisë të kthimeve të blerjeve.

(vi) Gjatë vitit kompania kishte shitur një automjet për 9,600 €. Paraja e gatshme e gjeneruar nga shitjet ishte regjistruar saktë në librin e arkës, por shuma prej 9600 ishin kredituar në llogarinë e shitjeve. Kosto historike e automjetit ishte 24,000 € dhe zhvlerësimi i akumuluar në datën e shitjes ishte 16,000 €, të cilat nuk ishin larguar nga llogaritë e kostos dhe zhvlerësimit të akumuluar pas shitjes së automjetit. Kompania i zhvlerëson automjetet me 25% me metodën drejtvizore me zhvlerësim proporcional në vitin e blerjes dhe asnjë zhvlerësim në vitin e shitjes.

#### **Kërkohet:**

**a)Përgatitni regjistrimet në Ditar për gabimet e gjetura. Postoni vlerat përkatëse në konto T të Llogarisë Pezull.**

**(12 pikë)**

**b)Përgatiteni në pasqyrë ku shihet efekti i korrigjimeve në fitimin e vitit (8 pikë)**

#### Zgjidhja e problemit 4

(i)	D Shpenzimet e telefonisë	1,320	
	Kr Llogaria Pezull		1,320
(ii)	D Impiantet	9,600	
	Kr SHp. E riparimit të impianteve	9,600	
	Dr Shp. E zhvlerësimit	960	
	Kr Zhvlerësimi I akumuluar	960	
(iii)	D Zbritjet e lejuara	620	
	Kr Llogaria Pezull	620	
	D Llogaria Pezull	730	
	Kr Zbritjet e pranuar	730	
(iv)	Dr Shp. E sigurimit	670	
	Kr Llogaria Pezull	670	
(v)	D Kthimet e shitjeve	6,750	
	Kr Llogaria Pezull	6,750	
	D Kthimet e blerjeve	6,750	
	Kr Llogaria Pezull	6,750	
(vi)	D Shitjet	9,600	

D Zhvl. I akumuluar 16,000

K Automjeti-Kosto 24,000

K Fitimi nga shitja e automjetit 1,600

#### Llogaria pezull

Saldo fillestare	15,380	Shpe telefonit (i)	1,320	
		Kthimet e shitjeve (v)	6,750	
		Kthimet e blerjeve(v)	6,750	
Zbritjet e pranuar	730	Zbritjet e lejuara (iii)	620	
		SHp e sigurimit (iv)	670	
			16,110	16,110

(b)	Korrigjimet tek fitimi i vitit	
(i)	Shp.e telefonit	(1,320)
(ii)	Impiantet dhe zhvlerësimi (9,600-960)	8,640
iii)	Zbritjet (730 - 620)	110
(iv)	Shp. E sigurimit	(670)
(v)	Korrigjimi I kthimit të shitjeve(6,750 X 2)	(13,500)
(vi)	Shitja e pasurive jo-qarkulluese (1,600- 9,600)	(8,000)

## Problemi 5

I keni në dispozicion informatat e mëposhtme sa i përket Pasqyrës të Ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023 ,si dhe Pasqyrën e Pozitës Financiare me datën 31 Dhjetor 2023.

### **Kompania "Bleta "**

#### **Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023**

	000 Eur
Fitimi para tatimit	2,064
Tatimi në fitim	<u>(360)</u>
Fitimi neto I vitit	1704

### **Kompania "Bleta" 2023 2022**

#### **Pasqyra e pozitës Financiare më 31 Dhjetor**

**Eur 000**

**Eur 000**

#### **Pasuritë jo-qarkulluese**

Toka 2,400 2,000

Impiantet dhe pajisjet 6,700 3,400

Mobiliet dhe orenditë 2,500 2,000

#### **Pasuritë qarkulluese**

Stoqet 1,160 1,000

Llogaritë e Arkëtueshme 720 460

Paraja e gatshme 15 360

---

**Total pasuritë 13,495 9,220**

#### **Ekuiteti dhe detyrimet**

Aksionet e zakonshme 9000 6,740

Premia 600 300

Rezerva e rivlerësimit e Tokës 400 0

Fitimet e mbajtura 2,104 940

#### **Detyrimet afatgjata**

Obligacionet me 10% që  
maturojnë me 31.12.2023 0 200

**Detyrimet afatshkurta**

Llogaritë e Pagueshme	900	730
Overdrafti(Mbitërheqja)	131	20
Tatimi i pagueshëm	360	290
<b>Total Detyrime dhe ekuiteti</b>	<b>13,495</b>	<b>9,220</b>

Informatat e mëposhtme i keni në dispozicion:

1. Impiantet dhe pajisjet që kishin vlerë neto në libra 400,000€ ishin shitur për 360,000€.
2. Zhvlerësimi i llogaritur në këtë vit për Mobilie dhe Orendi ka qenë 500,000 € ,kurse për Impiantet dhe pajisjet ishte 900,000 €.
3. Në Korrik “Bleta “ kishte paguar Dividend në vlerë 540,000 €.
4. Asnjë Toke , Mobilie dhe Orendi nuk ishte shitur gjatë vitit.

**Kërkohet:**

(a) Duke u bazuar në SNK 7 shpjegoni cka nënkuptohet me “ Ekuivalentët e keshit”  
(3 pikë)

(b) Shpjegoni së paku 2 informata nga Pasqyra e Rrjedhave të Arkës që do ti ndihmonin Investitorin gjatë analizimit të kompanisë. (2 pikë)

(c)Përgatiteni Pasqyrën e Rrjedhave të Arkës për vitin 2023 me metodën indirekte duke zbatuar SNK 7 (Pasqyra e Rrjedhave të Arkës).  
Shpjegoni qartë se si keni arritur deri te llogaritjet.

(15 pikë)



## Zgjidhja e problemit 5

a) Sipas SNK 7:

Ekivalentët e parasë së gatshme janë investime afatshkurtra, shumë likuide që janë shumë shpejt të kthyeshme në shuma të njohura të parasë së gatshme dhe që përmbajnë një rrezik minimal të ndryshimit në vlerë [prej kthimit në para të gatshme].

b) Cash flow-i është një element thelbësor për investitorët, sepse ndihmon në vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe potencialit të një investimi.

Cash flow-i pozitiv tregon që një biznes apo investim gjeneron të ardhura të mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e veta operative dhe të krijojë vlerë të shtuar. Nëse fluksi i parasë është negativ, investitorët mund të kenë dyshime mbi aftësinë e biznesit për të mbijetuar.

Investitorët kanë nevojë të dinë se një biznes ka likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij financiare (pagesa të kredisë, furnizuesit, taksat). Nëse një biznes nuk ka mjaftueshëm para në dorë, rrezikohet të hyjë në falimentim, pavarësisht se ka të ardhura të larta në letër.

Flukset e parave u japin investitorëve një pasqyrë më të qartë mbi kohën kur një biznes mund të ketë vështirësi financiare. Një cash flow i dobët mund të jetë një sinjal i hershëm që biznesi nuk po funksionon sipas pritshmërive.

Investitorët janë të interesuar të dinë nëse kompania ku kanë investuar gjeneron mjaftueshëm cash për të financuar zgjerime ose projekte të reja, pa u varur shumë nga financimi i jashtëm (huamarrje).

Cash flow-i tregon kapacitetin e një kompanie për të investuar në përmirësime, inovacione dhe zhvillime të reja që mund të rrisin vlerën e aksioneve ose të pronës.

**c) Pasqyra e Rrjedhave të Arkës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023.**

	€
Rrjedha nga Aktivitetet Operative	
Fitimi para tatimit	2,064
Korrigjimet për:	
+Shpenzimet e zhvlerësimit	1,400
+Shpenzimet e Interesit	20
-Humbja nga shitja e pasurisë jo-qarkulluese	40
-Rritja në stoqe	(160)
-Rritja në Ll/ Arkëtueshme	(260)
+Rritja në Ll/Pagueshme	170
Rrjedha nga operacionet	<b>3,274</b>
Interesi I paguar	(20)
Tatimi I paguar	(290)
<b>Rrjedha neto nga Aktivitetet Operative</b>	<b>2,964</b>
 Rrjedha nga Aktivitetet Investive	
Paraja e pranuar nga shitja e pasurive jo-qarkulluese	360
Pagesat për blerjen e pasurive jo-qarkulluese	(5,600)
<b>Neto rrjedha nga Aktivitetet Investive</b>	<b>(5,240)</b>
 Rrjedha nga Aktivitetet Financuese	
Emetimi I aksioneve	2,560
Ripagimi I Obligacioneve	(200)
Dividenda e paguar	(540)
<b>Neto rrjedha nga Aktivitetet Financuese</b>	<b>1,820</b>
<b>Rrjedhat e arkës gjatë vitit</b>	<b>(456)</b>
 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fillim(360-20)	340
 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fillim (15-131)	(116)

Mobilje dhe orendi		Impiantet dhe pajisjet	
s' 2,000 Blerjet 1000	500 Shp.e zhvler	s' 3,400 Blerjet 4600	900 Shp.e zhvler 400 Shitja e pasurise
s" 2,500		s" 6,700	

Tatimi I pagueshëm	
Tatimi I paguar 290	s' 290 360 Shp. E tatimit
	s" 360